



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 11 paragrafi 3 dhe 17 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Kërkesën për tërheqje të Aplikacionit për ndërtimin hidrocentralit në Lumin Lumbardhë, HC Reçan, me kapacitet prej 2.2 MW, Komuna e Prizrenit, të datës 20.09.2013 të ndërmarrjes “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, me adresë “fusha e Pejës” p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 24 tetor 2013 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** Kërkesa për tërheqje të Aplikacionit për ndërtimin hidrocentralit në Lumin Lumbardhë, HC Reçan, me kapacitet prej 2.2 MW, Komuna e Prizrenit, , të ndërmarrjes “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë.
- II. REFUZOHET dhënia e autorizimit preliminar** për ndërmarrjen “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, për ndërtimin e hidrocentralit në Lumin Lumbardhë, HC Reçan me kapacitet prej 2.2 MW, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

A r s y e t i m

- ZRRE me datë 27.08.2012 nga ndërmarrja ndërmarrjen “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e hidrocentralit në Lumin Lumbardhë, HC Reçan me kapacitet prej 2.2 MW, Komuna e Prizrenit.
- ZRRE me datë 24.10.2012 ka lëshuar shkresën lidhur me vlerësimin fillestar të aplikacionit, ku ka kërkuar nga ndërmarrja ndërmarrjen “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, të sjellë dëshmitë sipas shtojcës III të aplikacionit të cilat janë të rëndësishme për këtë fazë të vlerësimit si dhe ka kërkuar që dëshmitë ti sillni brenda afati ligjor të përcaktuar me nenin 11 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit.
- ZRRE me datë 07.11.2012 ka pranuar disa dëshmi shtesë nga ndërmarrja “Treangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, mirëpo kanë munguar dëshmitë kryesore që kanë të bëjnë kryesisht epikën 21,22,23 dhe 24 të aplikacionit.
- ZRRE me datë 11.09.2013 ka lëshuar shkresën ku ka kërkuar që brenda një afati shtesë prej (15) ditësh, t’iu përgjigjet kërkesave të ZRRE-së, lidhur me përmbushjen e dëshmimeve të kërkuara.



- ZRRE gjithashtu ka njoftuat apilkuesin se pas skadimit të afatit shtesë të cekur më lartë, në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit, do të vendosë për aplikacionin tuaj bazuar në dokumentet dhe informacionet ekzistuese, dhe të ju njoftojë për vendimin e saj.
 - ZRRE me datë 20 shtator 2013 nga përfaqësuesi i ndërmarrjes “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë, ka pranuar kërkesën për tërheqje të aplikacionit për ndërtimin e hidrocentralit në Lumin Lumbardhë, HC Reçan me kapacitet prej 2.2 MW, Komuna e Prizrenit, të datës 27 gusht 2012.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për tërheqje të aplikacionit dhe vlerësimit të aplikacioneve, si dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar